



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:114782

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05816111

KPPP.nr. 698/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, kundër debitorit “United Hospital” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811551599 dhe seli në Magjistralen Prishtinë - Ferizaj, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 118/24, i lejuar më datë 21.03.2024, nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 12.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET, në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “United Hospital” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811551599, ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 118/24, i lejuar më datë 21.03.2024, nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 118/24, i lejuar më datë 21.03.2024, nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj, MBETE NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, mbi bazën e dokumentit përbarimor; Vendimit Nr. 01/08-100/2023-B, të datës 27.09.2023, ka lejuar Urdhrit Përbarimor P.nr. 118/24, të datës 21.03.2024, me të cilin është obliguar debitori “United Hospital” Sh.P.K., që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj në emër të masës ndëshkimore vlerën prej EUR 1,000.00, së bashku me shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe rrjedhimisht tentimi për të detyruar debitorin në pagesën e vlerës prej EUR 1,000.00 është në kundërshtim me LPP. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbartimore në emër të përpilimit të prapësimin në vlerë prej EUR 208.00, sipas tarifës së OAK-së.

Kreditore nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkak të si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor përkatësisht vendimin mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditore, debitori, objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbartjes së detyrimit.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimit Nr. 01/08-100/2023-B, të datës 27.09.2023, mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, është bërë i plotfuqishëm dhe mban vullën e ekzekutueshmërisë së datës 28.12.2023, dhe rrjedhimisht i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për*

përmbaueshmëri”, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: “Vërtetimin për përmbaueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”.

Në këtë drejtim, gjykata gjen se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbaueshmëri në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Nga sa më sipër, bazuar duke u bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 698/24, datë 12.06.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.